

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

PUNIME NDËRTIMI

Kodi: PK-B-8-21

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2021

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME NDËRTIMI”

PK-B-8-21

I. Profili Profesional i punëtorit të ndërtimit

a) Karakteristikat e punëtorit të ndërtimit

Punëtori i ndërtimit do të jetë i aftë të kryejë *detyra* profesionale të ndërtimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të ndërtesave ose të rrugëve, si i punësuar apo i vetëpunësuar në ndërmarrje ose biznese që veprojnë në fushën e ndërtimit.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, ndërtuesi duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale si dhe *shprehi* profesionale, që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale të ndërtuesit. Suksesi i punëtorit të ndërtimit është i lidhur ngushtë edhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina, etj, sjellje që, e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

Punëtori i ndërtimit koordinon punën me grupet e tjera, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punëtorit të ndërtimit

Profesioni i ndërtuesit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e një ndërtesë të thjeshtë 2 katëshe. Ai/ajo mund të punësohet ose vetpunësohet në ndërmarrje publike apo private, në ndërmarrje prodhuese dhe të mirëmbajtjes të ndërtesës, por, edhe mund të vetëpunësohet duke krijuar një grup pune për punime ndërtimi.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e specialistit të punimeve të ndërtimit. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale si specialist i punimeve të ndërtimit apo trajnimit nëpërmjet punës, një specialist i punimeve të ndërtimit mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse, duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm në këtë proces. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të ndërtimit.

Për të zhvilluar aktivitet privat dhe për vetëpunësim, në fushën e ndërtimit duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Punëtorë në ndërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve, digave dhe të ngjashme”, me kod 9312, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Punime ndërtimi”.

Në përfundim të Kursit për “Punime ndërtimi”, kursantët do të jenë të aftë të:

- përdorin dhe interpretojnë projektin, dokumentacionin teknik në punime ndërtimi;
- përdorin projekt -zbatimin, udhëzues – katalogë, detaje, skica të gatshme;
- kryejnë planifikimin dhe organizimin e vogël të punës;

- parapërgatisin vendin e punës për punime ndërtimi (konstruksione b/a, ndërtim mure e punime rifiniture, ndërtim rrugë e trotuare);
- realizojnë matje teknike me instrumentat matës e nivelues;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, makineritë dhe materialet e duhura të punës;
- kryejnë punime konstruksioni b/a në një ndërtesë 2kat (plint, shtyllë, tra, pllakë, shkallë);
- kryejnë punime ndërtim çatie dhe mbulimi;
- kryejnë ndërtim mure tulle, guri dhe lidhjet e tyre;
- kryejnë suvatime të ndryshme;
- kryejnë punime të sistemeve të thata e patinimi;
- kryejnë punime bojatisje në mure me suva e pasuva, në sipërfaqe druri e metali;
- kryejnë punime nënshtresash, nivelime e izolime;
- kryejnë punime shtrim e veshje me pllaka;
- shtrojnë shtresat rrugore e trotuaret;
- kryejnë punime riparimi e mirëmbajtje në ndërtesa;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës;
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë mbas mbarimit të punës;
- zbatojnë legjislacionin e ndërtimit dhe atë tatimor, të lidhur me aktivitetin;
- kryejnë llogaritje volumesh të materialeve për çdo proces të punës;
- regjistrojnë të dhënat për faturat e lëshuara klientëve në regjistrimet e duhura;
- zbatojnë standardet e profesionit të ndërtuesit;
- komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët;

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Punime ndërtimi”

Pjesmarrësit në Kursin për “Punime ndërtimi” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Punime ndërtimi”

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Punime ndërtimi”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e punëtorit të ndërtimit	MK-02-286-21	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndërtuesit. 2. Kursanti interpreton projektin, detajet, skicat për punime ndërtimi. 3. Kursanti planifikon dhe organizon punën në punimet e ndërtimit.
2	Punime konstruksioni betonarmeje	MK-02-287-21	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit vendin e punës. 2. Kursanti ndërton plint dhe shtyllë betonarmeje 3. Kursanti ndërton tra dhe pllakë betonarmeje. 4. Kursanti ndërton shkallë betonarmeje. 5. Kursanti ndërton çati.

3	Ndërtim muresh dhe punime rifiniture	MK-02-288-21	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin e punës. 2. Kursanti ndërton mure me tulla. 3. Kursanti ndërton mure guri në lartësi. 4. Kursanti kryen suvatime. 5. Kursanti kryen punime të sistemeve të thata dhe patinime. 6. Kursanti kryen bojatisje.
4	Shtrim dhe veshje me pllaka.	MK-02-289-21	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin e punës. 2. Kursanti realizon nënshtresat, nivelimet dhe izolimet. 3. Kursanti shtron dhe vesh me pllaka
5	Ndërtim rrugësh	MK-02-290-21	40 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin e punës. 2. Kursanti ndërton shtresat rrugore. 3. Kursanti ndërton trotuaret.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Punime ndërtimi”.

1. Moduli “Hyrje në profesionin e punëtorit të ndërtimit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E PUNËTORIT TË NDËRTIMIT	MK-02-286-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të ndërtuesit, me projektin, detajet, skicat për punime ndërtimi në një ndërtesë të thjeshtë 2kat, me materialet, mjeteve, veglat, pajisjet e punës në punime ndërtimi, si dhe i aftëson për kryerjen e planifikimit dhe organizimit të punimeve të ndërtimit.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndërtuesit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë funksionet, detyrat, kërkesat dhe kushtet e punës së ndërtuesit - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës ndërtuesit. - të përshkruajë kërkesat profesionale për ndërtuesin. - të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të ndërtuesit. - të përshkruajë objektet dhe mjedisin e punës së ndërtuesit. - të përshkruajë mjetet, instrumentet, pajisjet dhe makineritë që përdor ndërtuesi. - të tregojë organizimin e punës në punimet e ndërtimit. - përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët. - të përshkruajë kuadrin ligjor bazë që vepron në sektorin e ndërtimit. - të shpjegojë zbatimin e kodit të punës dhe kërkesat ligjore për hapjen dhe veprimtarinë e bizneseve në fushën e ndërtimit. - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në ndërtim. - të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit në ndërtim. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. 	

RM 2 Kursanti interpreton projektin, detajet, skicat për punime ndërtimi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë objektin, elementet kryesore të një ndërtese 2 kat;
- të interpretojë detajet dhe skicat e ndryshme të projektit;
- të interpretojë shenjat dalluese të ndryshme që përdoren në projekt (detaje dhe skicat) për elementet të një ndërtese;
- të interpretojë shënimet teknike të fletëve të projektit për çdo lloj punimi ndërtimi;
- të interpretojë dokumente të tjera që përdoren në punimet e ndërtimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti planifikon dhe organizon punën në punimet e ndërtimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të kryejë instruktimin e rregullave të sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit në punime ndërtimi;
- të kryejë ngritjen e kantierit dhe nivelimin e sheshit të ndërtimit;
- të vendosë tabelat e sigurimit teknik;
- të interpretojë drejt radhën e kryerjes së punimeve;
- të përshkruajë plotësimin e standarteve për punime ndërtimi;
- të llogarisë paraprakisht volumet e punës dhe materialet sipas radhës së punimeve të ndërtimit;
- të kryejë kontrollin e tregut për çmimet e cilësinë e materialeve;
- të planifikojë dhe sistemojë bazën materiale të nevojshme sipas procesit të punës në vendin e duhur;
- të planifikojë mjetet, instrumentet dhe veglat e punës sipas procesit të punës;
- të planifikojë nevojën për burime njerëzore;
- të ndajë detyrat e punës sipas aftësive të punëtorëve;
- të hartojë grafikun e punimeve ditore, javore, mujore;
- të përshkruajë dokumentacionin që përdoret në organizimin e punës;
- të vendosë tabelat e sinjalistikës për punime operatore;
- të hartojë urdhra pune,proçes-verbale etj.;
- të koordinojë punën me grupe të punës të proçeseve të tjera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore, në objekt ndërtimi dhe mjedise pune ku kryhen punime ndërtimi.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet dhe demonstrimet që lidhen me çështjet që trajtohen në modul.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete si dhe të nxiten që të diskutojnë në lidhje me çështjet që trajtohen, detyrat që kryejnë dhe proceset që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së përvetësimit të njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart ndërtimi i pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Projekt zbatimi, detaje, skica të gatshme me punime ndërtimi (karpentierie, hekurkthimi, betonimi, murature, pllakashtrimi, bojatisje, rrugështrimi dhe mirëmbajtje).
 - Video projektorë, tabela të gatshme të rregullave të sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit dhe tabelat e sinjalistikës.
 - Mjedise reale të punës për punime ndërtimi, mirëmbajtjen dhe riparimin e punimeve të ndërtimit në një ndërtesë të thjeshtë 2kat.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për punime ndërtimi, mirëmbajtjen dhe riparimin e një ndërtesë 2kat.
 - Projekt zbatimi, katalogë, proces-verbale, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Punime konstruksioni betonarmeje”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME KONSTRUKSIONI BETONARMEJE	MK-02-287-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të realizuar parapërgatitjen e vendit të punës, punime konstruksioni betonarmeje (b/a), ndërtimin e çatisë, përdorimin e veglave të punës dhe të instrumentave matëse e niveluese përkatëse.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punëtorit të ndërtimit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti parapërgatit vendin e punës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të kryejë modimin e vendosjen e akseve në to;- të kryejë piketimin me mjetet gjeodezike e konfiguracionit të gërmimit;- të zbatojë rregullat e higjenes personale dhe të veshë uniformën e punës;- të marrë masa për MKZ dhe sigurimin teknik në vendin e punës;- të përzgjedhë bazën materiale për punime konstruksioni b/a;- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe veglat e punës të duhura;- të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve, pajisjeve dhe veglave të punës;- të pastrojë paraprakisht dhe sistemojë vendin e punës;- të kontrollojë funizimin me ujë dhe energji elektrike;- të kontrollojë skelën dhe vendosë rrjetën mbrojtëse për punimet në lartësi. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli. RM 2 Kursanti ndërton plint dhe shtyllë betonarmeje <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të masë, shënojë dhe presë faqet e kallëpit të plintit të shkallëzuar sipas skicës;- të montojë dy e nga dy faqet shkallëzimit të parë duke kontrolluar akset me spango dhe plumbçe sipas fletës së projektit;- të formojë zgarën e jastëkut të plintit të ndërtesës;- të drejtojë shufrat e hekurit;	

- të masë, shënojë dhe presë shufrat e hekurit;
- të kthejë shufrat punuese të hekurit sipas skicës;
- të përgatisë stafat e hekurit sipas skicës;
- të montojë shufrat e punës (fitilat) e shufrat shpërndarëse;
- të lidhë me tel bari stafat me largësinë e caktuar nga njëra-tjetra;
- të betonojë jastëkun e plintit b/a;
- të montojë dy e nga dy faqet e shkallëzimit të dytë, duke kontrolluar akset me spango dhe plumbçe sipas fletës së projektit;
- të kontrollojë kuotën e fillimit të shtyllës prej betoni të armuar (kuota e mbaruar e plintit dhe ndërkatit) me instrumente sipas fletës së projektit;
- të masë, shënojë dhe presë faqet e kallëpit të kollonave b/a;
- të masë, shënojë dhe presë shufrat vertikale të hekurit sipas fletës konstruktive;
- të përgatisë stafat sipas fletës konstruktive;
- të lidhë me tel bari me stafat, shufrat vertikale të hekurit duke i mbivendosur me fitilat e plintit sipas fletës konstruktive;
- të montojë kallëpin e kollonave dhe ta përforcojë me qaforet duke kontrolluar me instrumente akset dhe vertikalitetin e faqeve;
- të kontrollojë pozicionin e shufrave dhe shtresën mbrojtëse sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të pastrojë, lagë kallëpin e kollonave sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të përgatisë betonin me makineri sipas markës së dhënë;
- të hedhë, ngjeshë dhe rrafshojë betonin në kallëp sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të mirëmbajë plintin dhe shtyllën b/a pas betonimit sipas kushtit teknik të zbatimit;
- të dizarmojë në kohën e duhur sipas radhës elementet e kallëpit të plintit dhe kollonave;
- të riparojë sipërfaqet e betonuara të dëmtuara;
- të pastrojë dhe sistemojë veglat, mjetet dhe materialet mbas punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti ndërton tra dhe pllakë betonarmeje.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë, masë dhe shënojë kuotën e fundit të traut, kuotën e fillimit dhe mbarimit të ndërkatit dhe gjerësinë e trarit prej betoni të armuar të lidhur me pllakën sipas fletës

- së projektit;
- të masë, shënojë dhe presë elementet (fundin, faqet e traut dhe dyshemenë e pllakës) të kallëpit të traut të lidhur me pllakën sipas fletës projektit;
 - të vendosë skelat e varura (kryqet) të gatshme duke kontrolluar kuotën dhe nivelimin e tyre me mastar-nivelë;
 - të montojnë fundin e traut me skelat e varura (kryqet) duke kontrolluar nivelimin me mastar-nivelë;
 - të montojnë faqet anësore (fjankot) të mbështetura në skelat e varura (kryqet) me fundin e trarit duke i përforcuar dhe kontrolluar vertikalisht me mastar-nivelë;
 - të montojnë binarët e dyshemesë së pllakës me skelat mbajtëse (kryqet) duke kontrolluar kuotën dhe nivelimin e tyre me mastar-nivelë;
 - të montojnë armaturën e dyshemesë (ndërkatit) me binarët horizontalë duke kontrolluar kuotën dhe nivelimin e tyre me mastar-nivelë;
 - të masë, shënojë, presë shufrat e hekurit dhe kthejnë (sagomatë) shufrat e punës sipas fletës konstruktive të trarit prej betoni të armuar;
 - të drejtojnë, masë, shënojë, presë dhe kthejnë shufrat e hekurit për stafat (të hapura për tra **T**) sipas fletës konstruktive;
 - të lidhë shufrat e punës dhe ato montuese me stafat (formojnë skeletin e hekurit) sipas fletës konstruktive të trarit b/a;
 - të vendosë mbi rula Ø20 skeletin e hekurit në kallëp, duke kontrolluar pozicionin poshtë të shufrave të punës (para fiksimit të listelave përforcuesve horizontale);
 - të masë, shënojë, presë shufrat e hekurit dhe kthejnë (sagomatë) gjysmën e shufrave të punës sipas fletës konstruktive;
 - të drejtojnë, masë, shënojë dhe presë shufrat shpërndarëse sipas fletës konstruktive të pllakës b/a;
 - të shënojë në dyshemenë e kallëpit dhe të vendosë në pozicionin përkatës shufrat e punës sipas detajit të gatshëm;
 - të lidhë shufrat e punës me ato shpërndarëse (formojnë rrjetën e hekurit) me tel bari sipas skicës, vendosjen e rulave Ø10 për shtresën mbrojtëse;
 - të pastrojnë, lagë kallëpin para betonimit sipas kushteve teknike të zbatimit;
 - të përgatisë betonin me makineri sipas markës së dhënë;
 - të hedhë, ngjeshë dhe rrafshojë betonin në kallëp sipas kushteve teknike të zbatimit;
 - të mirëmbajnë traun dhe pllakën b/a pas betonimit sipas kushtit teknik të zbatimit;
 - të dizarmojë në kohën e duhur sipas radhës elementet e kallëpit të traut dhe pllakës b/a;
 - të riparojnë sipërfaqet e betonuara të dëmtuara;
 - të pastrojnë dhe sistemojnë veglat, mjetet dhe materialet

- mbas punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti ndërton shkallë betonarmeje.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë, masë dhe shënojë kuotën e përfunduar të dy ndërkateve në faqen e murit të kafazit të shkallës sipas fletës së projektit;
- të masë dhe shënojë kuotën e përfunduar të ndërkatit dhe pikën e fillimit të bazamakut të fundit tek pllaka e sheshpushimit në faqen e murit të kafazit të shkallës sipas fletës së projektit;
- të masë dhe shënojë vijën e pjerrësisë së rampës së parë (uljen nga pika e fillimit të bazamakut të fundit sa lartësia e tij dhe bashkimin me pikën e fillimit të bazamakut të parë) në faqen e murit të kafazit të shkallës sipas fletës së projektit;
- të masë dhe shënojë vijën paralele me trashësinë e pllakës së rampës së parë në faqen e murit të kafazit të shkallës sipas fletës së projektit;
- të masë dhe shënojë bazamakët e rampës së parë në faqen e murit të kafazit të shkallës sipas fletës së projektit;
- të vendosë dhe fiksojë skelat mbajtëse (kryqet) për pllakën e rampës së parë dhe sheshpushimit bashkë me traun e shkallës sipas detajit të dhënë;
- të masë, shënojë dhe presë armaturën e dërrasës së dyshemesë së rampës së parë dhe sheshpushimit bashkë me trarun sipas detajit;
- të montojë dërrasat e dyshemesë së rampës së parë dhe sheshpushimit bashkë me trarin te skelat mbajtëse (kryqet) sipas fletës së projektit;
- të masë, shënojë, presë dhe montojë faqen anësore sa gjatësia e rampës së parë me përforcuesit sipas fletës së projektit duke kontrolluar vertikalisht me mastar-nivelë;
- të masë dhe shënojë bazamakët e rampës së parë në faqen anësore sipas fletës së projektit;
- të përgatisë stafat, shufrat e punës e montuese sipas fletës konstruktive të pllakës së rampës, sheshpushimit dhe traut të shkallës sipas fletës projektit;
- të masë, shënojë, presë faqet paralele për çdo bazamak dhe pas lidhjes së armaturës së hekurit t'i montojë ato me faqen anësore, distancatorët, takot dhe përforcuesin përfundimtar sipas fletës së projektit;
- të kontrollojë vertikalisht dhe horizontalisht e tyre me mastar-nivelë;
- të formojë skeletin e armaturës e traut të shkallës dhe ta

- vendosin në kallëp sipas fletës konstruktive;
- të shënojnë në dyshtemenë e kallëpit të pllakës së rampës dhe sheshpushimit dhe të vendosë në pozicionin përkatës shufrat e punës sipas fletës projektit;
- të formojë rrjetën e hekurit për pllakën e rampës dhe sheshpushimit sipas fletës së projektit;
- të kontrollojë pozicionin e shufrave për elementet b/a dhe pastrojë, lagë kallëpin e dërrasës;
- të përgatisë betonin me makineri sipas markës së dhënë;
- të hedhë, ngjeshë dhe rrafshojë betonin në kallëp për pllakat e rampave me bazamakët, trarin e shkallës dhe pllakën e sheshpushimit duke kontrolluar nivelimin e betonit të bazamakëve sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të mirëmbajë shkallën b/a pas betonimit sipas kushtit teknik të zbatimit;
- të dizarmojë në kohën e duhur sipas radhës elementet e kallëpit të shkallës b/a;
- të riparojë sipërfaqet e betonuara të dëmtuara;
- të pastrojë dhe sistemojë veglat, mjetet dhe materialet mbas punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti ndërton çati.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë, masë dhe shënojë kuotat e mbështetjeve në mure të simuluar të elementeve përbërëse të konstruksionit mbajtës të çatisë prej druri sipas fletës së projektit;
- të masë, shënojë dhe presë elementet përbërëse të konstruksionit mbajtës të çatisë prej druri (mahi, elemente vertikale dhe diagonale, brez i sipërm dhe i poshtëm, kontraventime, etj) sipas fletës projektit;
- të montojë takot dhe brezat e poshtëm mbi mure duke kontrolluar nivelimin e tyre;
- të montojë sipas projektit: elementet vertikale mbi murin e mesit duke kontrolluar vertikalitetin e tyre, brezin e sipërm gjatësor duke i kontrolluar nivelimin dhe kontraventimet;
- të montojë sipas projektit mahitë mbi brezat e poshtëm
- e të sipërm dhe diagonalet;
- të montojë sipas projektit në çdo mahi dy dërrasat për formimin e strehës së çatisë;
- të mbulojë çatinë me materiale të ndryshme sipas fletës projektit;
- të vendosë ulluqet për kullimin e rreshjeve në mënyrë të

organizuar;

- të mirëmbajë dhe riparojë elementet e çatisë dhe mbulesën e saj;
- të pastrojë dhe sistemojë veglat, mjetet dhe materialet mbas punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt ndërtimi dhe mjedise pune ku kryhen punime ndërtimi.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punimeve të konstruksionit b/a, (plint, shtyllë, tra, pllakë, shkallë) të ndërtimit të çatisë dhe mbulesës së saj.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës ndërtimit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për punimet e konstruksionit b/a, ndërtimin dhe mbulimin e çatisë të mbikqyrur nga instruktori dhe respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirembajtjes së veglave dhe pajisjeve të punës.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune ndërtimi konstruksioni b/a, ndërtimi i çatisë dhe mbulesës së saj në një ndërtesë 2kat. Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për drejtime, matje, shënime, kthime, prerje, lidhje, sharrime etj.
 - Armaturë hekuri me Ø të ndryshme, betonforma për kallëpe, tel bari, dërrase, përforcues, skela të varura, përbërës të betonit, zgara hekuri, materiale dërrase, çatie dhe mbulesat, ulluqet.
 - Betonjerë, vibrator, sharrë dore, prerës hekuri, tavoline pune hekurkthyesi, çelës hekurkthimi, kubik, skelë e gatshme dhe rrjetë mbrojtëse kubik betoni, darë, pinca, mistri, lopatë, çekiç, intrumente matëse e niveluese, shënues, tranxhë, trapan, instrument gjeodezik etj.
 - Projekt zbatim, skica, detaje dhe shënime teknike përkatëse.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Ndërtim muresh dhe punime rifiniture”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	NDËRTIM MURESH DHE PUNIME RIFINITURE	MK-02-288-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të parapërgatitur vendin e punës, për ndërtimin e mureve prej tulle dhe guri, për kryerjen e suvatimeve e sistemet e thata, patinimet e bojatisjet.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punëtorit të ndërtimit”	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti parapërgatit vendin e punës. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të zbatojë rregullat e higjenës personale dhe veshë uniformën e punës;- të marrë masa për MKZ dhe sigurimin teknik në vendin e punës;- të përzgjedhë dhe grumbullojë bazën materiale sipas procesit të punës;- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe veglat e punës të duhura;- të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve, pajisjeve dhe veglave të punës;- të pastrojë paraprakisht dhe sistemojë vendin e punës;- të kontrollojë funizimin me ujë dhe energji elektrike;- të realizojë ndriçimin dhe ajrosjen e duhur në ambjentet e mbyllura;- të kontrollojë skelën dhe vendosë rrjetën mbrojtëse për punimet në lartësi. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli. RM 2 Kursanti ndërton mure me tulla. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë tullat $\frac{1}{2}$ dhe $\frac{3}{4}$ e saj;- të përgatisë llaçin sipas raportit të caktuar të përbërësve;- të shtrojë llaçin dhe vendosë tullat e para dhe spangon drejtuese për ndërtimin e murit në forme L, T;- të ndërtojë murin e tullës deri në lartësinë dhe gjatësinë e brezit dhe kollonetave duke lidhur me fitilat e lënë në shtyllat dhe lidhë fugaturat me njëra –tjetrën;- të lidhë fugaturat me njëra –tjetrën, kontrollojë me	

- skuadër, plumbçe e nivelë ndërtimin e murit;
- të formojë skeletin e armaturës së hekurit të brezit b/a horizontal dhe kollonetave b/a vertikale sipas detajit fletës projektit;
- të montojë armaturat gjatësore të brezit dhe tërthore të kollonetave;
- të përgatisë dhe përforcojë kallëpet e dërrasës;
- të përgatisë betonin, të hedhë në kallëp, vibrojë dhe nivelojë atë;
- të dizarmojë kallëpin dërrasës në kohën e duhur;
- të vendosë arkitrarët e gatshëm në kuotën dhe pozicionin e duhur;
- të ndërtojë në vazhdim muret në formë **L, T** duke kontrolluar lidhjet e fugave dhe këndet e drejta;
- të shtrëngojë muret me lidhjen në tavan;
- të mirëmbajë dhe riparojë muret e tullave sipas standartit;
- të pastrojë dhe sistemojë veglat, mjetet dhe materialet mbas punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti ndërton mure guri në lartësi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të piketojë me mjete gjeodezike trashësinë e murit;
- të përpunojë gurët para vendosjes në mur;
- të përgatisë materialin lidhës;
- të shtrojë llaçin dhe ndërtojë murin e gurit natyrorë duke lidhur fugaturat;
- të kontrollojë murin me instrumente matëse e niveluese;
- të ndërtojë kallëpin e brezave b/a;
- të vendos shufrat e hekurit dhe betonojë brezin b/a të murit;
- të ndërtojë kolona prej guri sipas detajeve;
- të ndërtojë qemerët e dyerve dhe dritareve sipas detajeve;
- të pastrojë/përpunojë fugaturat e llaçit në kohën e duhur;
- të mirëmbajë dhe riparojë muret gurit sipas standartit;
- të pastrojë dhe sistemojë veglat, mjetet dhe materialet mbas punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen suvatime.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë sipërfaqet me instrumente matëse e niveluese;
- të pastrojë dhe lagë sipërfaqet që do të suvatohen;
- të përgatisë me krahë /makineri llaçin e çimentos (sprucon) sipas përbërësve në raportit të caktuar;
- të spërkasë me spruco sipërfaqet e tavaneve dhe mureve me krahë/ makineri;
- të fiksojë këndoret metalike të gatshëm;
- të vendosë takot për fashaturat në sipërfaqe duke kontrolluar horizontalitetin dhe rrafshhtësinë me mastar-nivelë;
- të mbushë me llaç fashaturat sipas nivelimit të takove në sipërfaqe duke kontrolluar me mastar-nivelë;
- të përgatisë me krahë /makineri llaçin e përzier(mbushjen) sipas përbërësve në raportin e caktuar;
- të mbushin midis fashaturave me llaçin e përzier shtresën e dytë të suvatimit të sipërfaqeve me vegla dore/makineri, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të presë me mastar llaçin e tepërt në nivelim me fashaturat;
- të përziejë finon e gatshme me ujë deri në konsistencën e duhur;
- të hedhë finon në sipërfaqe vegla dore, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të fërkojë finon në sipërfaqe me vegla dore, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të riparojë dhe mirëmbajë sipërfaqet e suvasë;
- të kryejë pastrimin e veglave, pajisjeve dhe vendin e punës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen punime të sistemeve të thata dhe patinime.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të realizojë matjet dhe kontrollin e elementëve përbërës të sistemeve të thata;
- të kontrollojë me instrumente matëse e niveluese sipërfaqet që do punohen;
- të bëjë matjet dhe shënime për pozicionimin e strukturën metalike për sistemet e thata sipas skicës;
- të realizojë montimin me upa e elementëve/ profilet metalike sipas skicës;
- të vendosë materialin izolues për izolimin termik/akustik;
- të shënjojë vijat e prerjes mbi panele apo pllaka gipsi me

- mjete shënjuese sipas kushteve teknike të projektit;
- të presë pllakat e gipsit sipas fletës së projektit;
- të pastrojë pjesët anësore të paneleve me thikë, zdrukth apo mjete të tjera për të siguruar që bashkimet janë të drejta;
- të zmusojë pllakat e gipsit sipas kushteve teknike të projektit;
- të hapë, sipas rasteve dritaret e kontrollit bazuar në projekt;
- të montojë pllakat e gipsit në strukturën metalike sipas projektit;
- të vendosë siç duhet rrjetën në pikat e bashkimit midis pllakave të gipsit;
- të realizojë zëvendësimin e elementëve të konsumuar apo të difektuar dhe mirmbajë ato;
- të stukojë me vegla dore bashkimin midis fugave të pllakave të gipsit, vrimave të upave etj;
- të patinojë me një shtresë të hollë sipërfaqet e sistemeve të thata;
- të fërkojë me letër zmeril sipërfaqen e patinuar;
- të riparojë e mirmbajë sipërfaqen e patinuar;
- të pastrojë nga pluhurat sipërfaqen e patinuar;
- të kryejë pastrimin e veglave, paisjeve dhe vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 6 Kursanti kryen bojatisje.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të pastrojë paraprakisht vendin e punës që do bojatiset;
- të mbulojë sipërfaqet që nuk bojatisen;
- të përzgjedhë drejt bojërat e gatshme me kompjuter sipas kërkesës së klientit;
- të lyejë sipërfaqen me astar të gatshëm;
- të përziejë bojën e parapërgatitur sipas llojit të sipërfaqes dhe kërkesës klientit;
- të bojatisë tavanin në mjedisin e brendshëm dhe të jashtme ballkon me dorën e parë e pas tharjes së saj me dorën e dytë, në sipërfaqe suvaje e josuvaje;
- të kryejë prerjen e kufirit të bojatisjes midis dy sipërfaqeve me ngjyra të ndryshme dhe objekteve që nuk do të bojatisen, në ambiente të brendshme e të jashtme në sipërfaqe suvaje e josuvaje;
- të bojatisë me bojën e parapërgatitur sipas standarteve sipërfaqet e brendshme (muret, shtyllat, trarët, kornizat e dritareve etj.) dhe fasadën me dorën e parë e pas tharjes së saj me dorën e dytë, sipas katalogut në sipërfaqe me suva e pa suva;

- të riparojë me stuko rezine zonat e dëmtuara dhe ta smerilojë plotësisht sipërfaqen prej druri e metali sipas kushteve teknike;
- të bojatisin me pistoletë boje sipërfaqet prej druri me rezinë të gatshme dhe sipërfaqet prej metali me bojë kundra ndryshkut sipas kushteve teknike me dorën e parë e pas tharjes së saj me dorën e dytë, sipas llojit;
- të heqë me kujdes letrën ngjitëse mbrojtëse dhe të pastrojë sipërfaqet e plintusave, dyshemesë, davancaleve, xhamave të dyer – dritareve, parapeteve, etj.
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet e punës pas punimeve të bojatisjes;
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit të bojatisjes në sipërfaqe me suva e pa suva, druri, betoni e metali;
- të magazinojë hermetikisht bojrat dhe holluesit e tyre;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise pune ku kryhen punime ndërtim muresh e rifiniture.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore në ndërtimin e mureve prej tulle, guri, kryerjen e suvatimeve, sistemet e thata, patinimet e bojatisjet.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për parapërgatitjen e vendin të punës, ndërtimin e mureve prej tulle, guri, kryerjen e suvatimeve e sistemet e thata, patinimet e bojatisjet, të mbikqyrur nga instruktori për respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune të praktikës për ndërtimin e mureve prej tulle, guri, kryerjen e suvatimeve e sistemet e thata, patinimet e bojatisjet.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për parapërgatitur vendin e punës, ndërtimin e mureve prej tulle,
-

guri, kryerjen e suvatimeve e sistemet e thata, patinimet e bojatisjet.

- Betonjerë, pompë suvatimi, tako e fashatura drejtuese, kubik llaçi, mallë, bërda, mistri, kovë, govatë, furçë, zmerilues,
 - Tulla të ndryshme, gurë natyrorë, profile, upa, stuko këndorë metalikë të gatshëm, patinimi, astar, ujë, llamarine, kartonxhes, polesterol, rrjetë bashkimi, shkallë bojaxhiu, skelë, rul, govatë boje, furçe boje, pistoletë boje, hollues, bojë muri, bojë rezine, pigmente, bojë hekuri, bojë druri,
 - Projekte zbatimi, detaje, skica të gatshme
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, proces-verbale, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Shtrim dhe veshje me pllaka”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHTRIM DHE VESHJE ME PLLAKA	MK-02-289-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të parapërgatitur vendin e punës, realizimin e nënshtresave të katit përdhe, nivelimin e ndërkatit dhe izolimin e tarracës si dhe të shtrojnë dhe veshin me pllaka sipërfaqet e ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e punëtorit të ndërtimit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit vendin e punës. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zbatojë rregullat e higjenës personale dhe veshë uniformën e punës; - të marrë masa për MKZ dhe sigurimin teknik në vendin e punës; - të përzgjedhë dhe grumbullojë bazën materiale sipas procesit të punës; - të përzgjedhë mjetet, paisjet dhe veglat e punës të duhura; - të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve, paisjeve dhe veglave të punës; - të parapërgatisë sipërfaqet e katit përdhe, ndërkatit dhe tarracës; - të pastrojë dhe parapërgatisë sipërfaqet para nisjes së shtrimit dhe veshjes me pllaka; - të kryejë riparimet e mundshme të sipërfaqeve të niveluara për shtrim me pllaka; - të fusë në ujë pllakat sipas llojit të tyre; - të pastrojë paraprakisht dhe sistemojë vendin e punës. - të kontrollojë funizimin me ujë dhe energji elektrike; - të kontrollojë skelën dhe vendosë rrjetën mbrojtëse për punimet në lartësi. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgimi me listë kontrolli. <p>RM 2 Kursanti realizon nënshtresat, nivelimet dhe izolimet. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kontrollojë kuotat e nënshtresave të katit përdhe, nivelimin e ndërkatit dhe izolimin e tarracës sipas fletës 	

- projektit;
- të vendosë udhëzuesin për trashësinë e shtresës së dheut të ngjeshur;
- të lagë dhe ngjeshë me mjete dore shtresën e dheut deri në konsolidim të mjaftuar;
- të shtrojë dhe ngjeshë shtresat e inerteve sipas madhësisë së kokrrizave;
- të shtrojë betonin e gatshëm dhe rrafshojë atë deri në kuotën e caktuar;
- të shtrojë shtresën hidroizoluese sipas fletës së projektit;
- të shtrojë e rrafshojë shtresën e llaçit të çimentos sipas fletës së projektit;
- të shënojë kuotën e përfunduar të nivelimit të ndërkatit;
- të shënojë kuotën me lartësi 1m nga kuota e dyshemesë së përfunduar në murin e kafazit të shkallës;
- të zhvendosë dhe shënojë - 1m pikat referuese të mureve në sipërfaqen që më pas do shtrohet me pllaka;
- të fiksojë fashaturat e gatshme per nivelimin e dyshemesë;
- të mbushë me beton të varfër ,rrafshojë dhe nivelojë sipërfaqen e dyshemesë ndërkatit në kuotën e caktuar më parë;
- të shtrojë materialin termoizolues me dy shtresa;
- të lyejë tarracën me prajmer liquid me dy duar;
- të shtrojë qilimin hidroizolues sipas detajit të fletës projektit;
- të riparojë dhe mirmbajë punimet e nënshtresës, nivelimit dhe izolimit;
- të kryejë pastrimin e veglave,paisjeve dhe vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti shtron dhe vesh me pllaka.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë skicat e gatshme me mënyra të ndryshme veshje e pllakashtrimi;
- të kryejë matjet e duhura për fillimin e punimeve;
- të riparojë në rast nevoje sipërfaqet që do shtrohen e do vishen;
- të përgatitë materialin ngjitës (kollën);
- të fiksojë pllakat e shtrimit referuese dhe spangon drejtuese;
- të shtrojë pllakat, vendosë kryqet dhe kontrollojë me mjete niveluese;
- të veshë me pllaka muret, vendosë kryqet dhe kontrollojë me mjete niveluese;
- të presë pllakat plotësuese sipas vendeve bosh duke parë skicën;

- të vendosë pllakat plotësuese sipas skicës;
- të heqë kryqet e pastrojë fugat për hedhjen e bojakut;
- të hedhë bojakun e gatshëm midis fugave deri në ngopjen e tyre;
- të kryejë pastrimin të sipërfaqes së veshur e shtruar me pllakave nga bojaku i tepërt në kohën e duhur;
- të riparojë e mirëmbajë sipërfaqen e veshur e të shtruar me pllaka;
- të kryejë pastrimin e veglave, pajisjeve dhe vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt ndërtimi ku kryhen punime shtrimi dhe veshje me pllaka.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të nënshtresave të katit përdhe, nivelimin e ndërkatit dhe izolimin e tarracës si dhe të shtrimit dhe veshjes me pllaka
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në objekt e mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për të parapërgatitur vendin e punës, realizimin e nënshtresave të katit përdhe, nivelimin e ndërkatit dhe izolimin e tarracës si dhe të shtrajnë dhe veshin me pllaka ambjentet në mbikqyrjen e instruktorit duke respektuar e rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirembajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriteve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës për shtrim e veshje me pllaka
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për shtrim e veshje me pllaka.
 - Pllaka veshëse e shtrimi të ndryshme, kryqe, spango, materiale izolimi (letër katrama, prajmer, etj) bojak i gatshëm, kollë, beton i varfër, llaç çimento, shënues, instrument nivelues gjeodezik, fshesë, pastrues bojaku, gozhdë, mallë, mistri, lopatë, govatë
-

kovë, ujë, prerës pllakash, pinca, darë, gur freksibël, trapan, punto

- Skica, detaje dhe shënime teknike të ndryshme, pajisjeve dhe instrumente për realizimin e proceseve.
 - Projekt zbatimi, kataloge, manuale, proçes-verbale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Ndërtim rrugësh”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	NDËRTIM RRUGËSH	MK-02-290-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të parapërgatitur vendin e punës, për të realizuar ndërtime rrugësh dhe trotuaresh, për të kryer mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e punëtorit të ndërtimit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti parapërgatit vendin e punës Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të zbatojë rregullat e higjenes personale dhe veshë uniformën e punës;- të marrë masa për MKZ dhe sigurimin teknik në vendin e punës;- të përzgjedhë dhe grumbullojë bazën materiale sipas procesit të punës;- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe veglat e punës të duhura.- të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve, pajisjeve dhe veglave të punës;- të pastrojë paraprakisht dhe sistemojë vendin e punës;- të kontrollojë funizimin me ujë dhe energji elektrike;- të piketojë aksin e rrugës dhe gjerësinë e trotuarit me instrumente gjeodezike;- të gërmojë dherat e tepërta të rrugës dhe trotuarit dhe zbankojë ato;- të shënojë kuotat e shtresave rrugore (zhavorrit, çakullit stabilizantit, betonit dhe rërës);- të pastrojë paraprakisht dhe të sistemojë vendin e punës;- të vendosin tabelat sinjalizuese për punimet e rrugës dhe mirëmbajtjes së tyre sipas rregullave të kodit rrugor dhe kushteve teknike. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli. RM 2 Kursanti ndërton shtresat rrugore. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të kontrollojë kuotat, akset sipas modinave, përmasat e tabanit të rrugës me instrumente matëse e niveluese sipas fletës së projektit;	

- të kryejë nivelimin gjatësor të aksit të rrugës me instrumente;
- të ndërtojë drenazhet për kullimin e ujrave të tepërta;
- të ndërtojë muret mbrojtëse në të dy anët e trupit të rrugës;
- të ndërtojë skarpatet mbrojtëse për largimin e ujërave;
- të kryejë ngjeshjen me makineri (cilindrimin) e kasonetës;
- të lagë me makineri sipërfaqen që do shtrohet;
- të hedhë shtresën e parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike;
- të kryejë cilindrimin e shtresës së parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike me makinë cilindruese;
- të hedhë shtresën e dytë (të sipërme) me zhavorr të imët / çakëll sipas kushteve teknike;
- të kryejë cilindrimin e shtresës së dytë (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll sipas kushteve teknike me makinë cilindruese;
- të pastrojë sipërfaqen dhe ta spërkasë atë me bitum të lëngshëm me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike;
- të lagë me ujë sipërfaqen asfaltbetonit e rular të rrugës;
- të kryejë cilindrimin e shtresës së asfalt-betonit me mjetin ngjeshës (cilindrues) sipas kushteve teknike;
- të heqë shtresën e asfalt-betonit të dëmtuar me mjete dore ose të mekanizuara për riparimin e rrugës;
- të pastrojë shtresat ekzistuese të rrugës me mjete dore/mekanizuara;
- të hedhë shtresën e binderit dhe e ngjeshin atë me rul dore ose të mekanizuar sipas kushteve teknike;
- të hedhë shtresën e asfalt-betonit dhe e ngjeshin atë me rul dore ose të mekanizuar sipas kushteve teknike;
- të kryejë pastrimin e mjeteve dhe të vendit të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti ndërton trotuaret

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë kuotat, sipas modinave, përmasat e trotuarit me instrumente matëse e niveluese sipas fletës së projektit;
- të ngjeshë dheun e bazamentit të trotuarit me makineri;
- të formojë fashaturat niveluesve te bordurave të trotuarit me beton të varfër në kuotën e caktuar;
- të fiksojë mbi fashatura bordurat e gatshme te trotuarit;
- të shtrojë dhe ngjeshë me rol dore shtresat e zhavorrit dhe granilit duke respektuar kuotat e caktuara;

- të hedhë betonin e varfër të gatshëm, rrafshojë atë duke ruajtur vijën pjerrësisë sipas skicës;
- të hedhë rërën në sipërfaqe duke kryer nivelimin e saj
- të shtrojë me pllaka trotuari sipërfaqen sipas skicës;
- të rulojë sipërfaqen e shtruar dhe mbushë fugat e pllakave me rërë sipas kushteve teknike;
- të pastrojë nga rëra e tepërt sipërfaqen e shtruar me pllaka trotuari në kohën e duhur;
- të mirëmbajë e riparojë trotualet sipas kushteve teknike;
- të kryejë pastrimin e veglave, paisjeve dhe vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë detyrat administrative e tregtare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt ndërtimi rrugë e trotuare.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të ndërtimit shtresave rrugore e trotualet.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të parapërgatitur vendin e punës, për ndërtime të shtresave rrugore e trotualet dhe riparimin e mirëmbajtjen e tyre. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi shkalla e arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune ndërtimi të shtresave rrugore, trotualet, të riparimit e mirëmbajtjes së tyre.
 - Pajisje, makineri, instrumente gjeodezike,
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës për ndërtimin e shtresave rrugore, trotualet, të riparimit e mirëmbajtjes së tyre.
 - Rul dore dhe makineri, lopata, kovë zifti, krehër dore, karrocë, kazma, çekiç, makineri asfalto-betoni,
 - Komplet i instrumenteve të nevojshme.
 - Granil i hollë, beton i gatshëm, tuba drenazhimi, inerte me granulometri të ndryshme, asfalto-beton i gatshëm, stabilizant, ujë, autobot për lagjen e rrugës, pllaka trotuari, bordura të gatshme, spango, gozhdë, rërë, tabela sinjalizuese.
 - Projekt zbatimi, detaje e skica të punimeve rrugore e trotuare
 - Katalloge, manuale, proces- verbale, udhëzuesat, materialet të përdorura në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-